




| | |
|---|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO | |
| AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY | |
| Dep. | 2-0/DPK |
| Dep. | |
| Dep. | |
| Nr. I faq. | |
| Broj stranica | 02 |
| Nr. pages | |
| Nr. Prot. | 01-850/14 |
| Br.Prot. | |
| Prot No. | |
| Data | |
| Datum | |
| Date | 12-03-2014 |
| PRISHTINE | |



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 11.03.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-3302-13 për z.Ismet Hajrullahu – Këshilltar për media në Kuvendin e Kosovës, për shkak se është shmangur situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesë në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-02-3302-13, për Zyrtarin e lartë, z. Ismet Hajrullahu – Këshilltar për media në Kuvendin e Kosovës dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Ismet Hajrullahu fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), pas të cilës ai është paraqitur në AKK, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Hajrullahu, është deklaruar se do t'i bëjë këto ndryshimet e kërkuar për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z.Hajrullahu, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi biznesin" (DPK-03-645-14) në të cilën shihet se te biznesi privat, N.T.SH."BEU", z.Hajrullahu, është tërhequr nga funksioni i personit të autorizuar të këtij biznesi, dhe ka emruar një "person të besuar" në këtë funksion, ashtu siç e parashev edhe ligji. Këtë për shkak se z.Hajrullahu vazhdon të ushtroj funksionin e tij publik, si Këshilltar për media në Kuvendin e Kosovës.


II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znej. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znej. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit



Mungos Elvir TFF